



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
THIRRJA E HAPUR DEDIKUAR
“FONDIT TË TEATRIT PËR TË RINJ”

Në kuadër të 110-vjetorit të Pavarësisë, si dhe me shpalljen e Tiranës “*Kryeqyteti Europian i Rinisë*”, nga Forumi Europian i Rinisë, Ministria e Kulturës së Shqipërisë, në përparësitë e saj për këtë vit, organizon veprimtari të rëndësishme kulturore dhe artistike.

Në përputhje me misionin dhe politikën e Ministrisë së Kulturës mbi nxitjen, promovimin dhe krijimin e hapësirave mbështetëse për skenën e pavarur artistike, e veçanërisht në fushën e teatrit, shpallet **“Fondin e Teatrit për të Rinj”** përgjatë vitit 2022”.

Projektet teatrale përfituese nga ky fond do të realizohen nën kujdesin e Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, në bashkëpunim me teatrot e rretheve, duke sjellë në vëmendje dramaturgjinë bashkëkohore edhe shqiptare në rang vendi; gjithëpërfshirjen e artistëve të rinj në disiplinën e teatrit; pasurimin e fondit të teatrit nga të rinjtë.

Në kuadër të “Paktit me Universitetet”, të rikonfirmuar ndërmjet Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe Universitetit të Arteve, Fakultetit të Artit Skenik, institucionet angazhohen të jenë partnerë në zhvillimin e kulturës së artit skenik, duke promovuar kapacitete të reja krijuese dhe artistike.

Periudha e realizimit Prill - Dhjetor 2022.

Mosha e krijuesve dhe interpretuesve të veprës të jetë deri në 35 vjeç.

Përmes “Fondit të teatrit për të rinj, në vitin 2022”, me një shumë prej 10 milionë lekësh synohet:

- ✍ nxitja dhe aktivizimi i krijuesve dhe interpretuesve të rinj
- ✍ risjellja në një formë të re e festivalit të të rinjve
- ✍ gjallërimi dhe lëvizja teatrale në rang vendi
- ✍ krijimi i lëvizjes teatrale në bazë të rajoneve

Fondi do të përmbajë një repertor prej 7 shfaqjesh, të dramaturgëve shqiptarë dhe bashkëkohorë.

- ✍ Veprat që do të propozohen dhe përzgjidhen të kenë deri në 4 personazhe.
- ✍ Komisioni që përzgjedh veprat dhe regjisorët me prezantimet e tyre të jetë Bordi Artistik i Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.
- ✍ Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, do të propozojë një repertor të veprave, si një mundësi e dytë, në rast se projektet regjisoriale të paraqitura nuk janë në nivelin apo në kriteret që synon Fondi i Teatrit për të Rinj.
- ✍ Shtrirja gjeografike e produksioneve teatrale, të paraqitura në një formë bashkëprodhimi me teatrot e rretheve, adreson regjisorët të punojnë dhe sigurojnë mbi mbarëvajtjen e premierave në teatrot e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Vlorës, Durrësit, Fierit,
- ✍ Aktorët e jashtëm do të përzgjidhen përmes audicioneve.
- ✍ Teatrot e rretheve do të mbështesin projektet e këtij fondi, përmes logjistikës teatrale, skenografinë dhe kostumografinë sipas mundësive buxhetore të tyre.

- ✍ Në festival mund të marrin pjesë edhe shfaqje të realizuara nga krijues të rinj jashtë këtij fondi dhe që plotësojnë kriteret e thirrjes.
- ✍ Një prej shfaqjeve do i dedikohet moshës së adoleshentëve deri në 18-vjeç, dhe do të jetë shëtitëse në rang vendi.
- ✍ Premierat e shfaqjeve propozohen të shfaqen në teatrot ku do të punohen veprat, më tej reprizat e shfaqjeve propozohet të vijnë në TKEKS, përmes një kalendari të strukturuar brenda repertorit të teatrit.
- ✍ Në përfundim të punës për të gjitha veprat, propozohet organizimi i një jave të dedikuar i festivalit të teatrit për të rinj, pranë Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, duke e finalizuar me ndarjen e çmimeve për të gjitha kategoritë pjesëmarrëse, nga një juri profesioniste.

Afati i aplikimeve :
30 Mars-15 Prill

Shpallja e fituesve:
29 Prill

Kriteret e Aplikimit:
CV
ID
Llogaria Bankare:
Sinopsi
Platforma
Preventivi

Dokumentacioni dorëzohet fizikisht pranë njësisë së protokollit të Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.